

**RAPORT NGA PROCESI I KONSULTIMIT PËR
PROJEKTLIGJIN PËR NDRYSHIM DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.04/L-060 PËR
MBETURINA**

Hyrja/sfondi

Projektligji për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturina, është hartuar duke e parë si nevojë për të rregulluar sa më mirë fushën e menaxhimit të mbeturinave.

Ky projektligj është duke e ndryshuar Ligjin Nr. 04/L-060 për Mbeturina, me qëllim të thjeshtësimit të Lejeve dhe Licencave, respektivisht, për lehtësim të procesit për lëshimin e licencës, zvoglimin e tarifave dhe shkurtrimin e kohës për lëshimin e lejeve, në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës të Republikës së Kosovës.

Qështje kryesore që shtjellohen në këtë Projektligj është rregullimi i dispozitave të ligjit në fuqi, krijimit të kushteve për hartimin e legjislacionit sekondare në fushën e mbeturinave, përmirësimin e statusit të tanishëm për menaxhimin e mbeturinave, i cili ende është në gjendje jo të mirë të organizuar, jo plotësisht i zbatuar. Plotesimi dhe ndryshimi i Ligjit për mbeturina dhe zbatimi i tij do të ketë ndikime të ndieshëm mjedisorë, duke e bërë një nga prioritetet kombëtare në të ardhmen duke synuar zbatimin e parimit të Hierarkisë së Menaxhimit të Mbeturinave dhe përmirësimin e legjislacionit kombëtarë dhe përafrimin e tij me legjislacionin e BE-së, ligjet apo dokumentet qeveritare që autorizojnë përgatitjen e politikës/ projektakti normativ.

Objektivat kryesore që synojnë të arrihen me politikë - eleminimi i Licencimit për menaxhimin e mbeturinave, që konsiderohet si lehtësim/reduktim i lejimeve në fushën e mjedisit, dhe që do të kompensohet me Lejen mjedisore dhe Lejen mjedisore komunale.

Me 23.07.20 sipas vendimit me Nr.3500/20 nga sekretari i përgjithshëm i ish-MEA-së, është nxjerr Vendim për Grupin Punues për hartimin e Projektligjit për Ndryshim dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturina, në perberje nga:

- 1.Enver Tahiri - kryesues, DMMU/MMPHI
- 2.Ibrahim Balaj - zëvendës kryesues, DMMU/MMPHI
- 3.Lindita Sopa - anëtare, DMMU/MMPHI
- 4.Tafe Veselaj - anëtar, AMMK/MMPHI
- 5.Safete Kuqi – anëtare, IM/MMPHI
6. Florije Kika – anëtare, DL /MMPHI
7. Albulena Maloku - anëtare, DFSHP/MMPHI
8. Hidajete Zhuri - anëtare, DIE/MMPHI
9. Zana Radoniqi – anëtare, MF
10. Donika Çeta – anëtare, ZKM
- 11.Iber Elezaj – anëtar, AAK
12. Ereza Abrashi - anëtare, DPS/ZKM

Grupi punuese sipas procedurave dhe praktikave të rregullta të hartimit të legjislacionit, duke pas parasyshë kompleksicitin e fushës së mbeturinave është konsultuar dhe ka analizuar konceptin e hartuar nga Projekti Bankës Botërore, lidhur me thjeshtësimin e lejeve dhe licencave.

Është konsultuar pjesërisht edhe legjislacioni i BE për mbeturina:

- Direktiva 2008/98 / EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 19 nëntorit 2008 mbi mbeturinat;
- Direktiva e Komisionit (BE) 2015/1127 e 10 korrikut 2015 që ndryshon Aneksin II të Direktivës 2008/98 / EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi mbeturinat;
- Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 1357/2014 e 18 Dhjetorit 2014 që zëvendëson Aneksin III të Direktivës 2008/98 / EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi mbeturinat;
- Rregullorja e Këshillit (BE) 2017/997 e 8 Qershorit 2017 që ndryshon Aneksin III të Direktivës 2008/98 / EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me pronën e rrezikshme HP 14 ‘Ekotoksike’;
- Direktiva (BE) 2018/851 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 30 maj 2018 që ndryshon Direktivën 2008/98 / EC mbi mbeturinat;

Pas konsultimeve të dokumenteve të theksuara dhe pas disa informatave të grupit punues përmes E-mailit, për draftin në hartim, konsultimeve me palë të tjerë brenda MMPHI-së si atë të AMMK-së, Inspektoratin është hartuara Projektligji përmes të cilit anulohen dispozitat për licencimin e menaxhimit të mbeturinave.

Ecuria procesit të konsultimit

Projektligjin për Ndryshim dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturina është zhvilluar në harmoni me nenin 7, të Rregullores Nr. 09/2011 së Punës të Qeverisë së Republikës Kosovës ku është dërguar për Konsultime Paraprake subjekteve të përcaktuar me legjislacion. Gjithashtu në harmoni me Rregulloren (QRK) Nr. 05/2016 për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik është publikuar në Platformë Online për Konsultime Publike të ish-MMPH-së. Periudha e konsultimeve publike në Platformen Online për Konsultime Publike të MMPHI-së ishte nga 18.03.2021 deri me 11.04.2021.

Gjatë periudhës së konsultimeve nga subjekte e përcaktuara me listen- Adresar për institucionet përkatëse për konsultim paraprak sipas Nenit 7 dhe konsultim publik sipas Nenit 32 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011 si dhe Rregullores (QRK) Nr.05/2016 për Standardet minimale për procesin e Konsultimit Publik, dhe atyre në Platformen online për konsultime publike të MMPHI, janë paraqitur kontributet si në tabelen vijuese:

Nëse është e nevojshme informatat paraqiten në grafika dhe tabela.

Metodat e Konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesmarrësve/kontribuesve
1. Shpallur permes E-mailit	15 ditë	-
2. Konsultimet me shkrim / në mënyrë elektronike;	vazhdimësi	-
3. Intervistat/takimet sy në sy	vazhdimësi	-
4.	/	

Përmbledhje e kontributeve të pranuar gjatë procesit të konsultimit

Lidhur me procesin e konsultimit për Projektligjin për Ndryshim dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturina, janë ofruar ca kontribute nga palët e interesit (6 – palë) si që janë shënuar në tabelën më poshtë, kryesisht nga organet kompetente duke përfshirë komentet e institucioneve përgjegjëse e sugjeruese nga Zyra e Kryeministrit dhe përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë, nga GIZ, zyra e KE- në Kosovë, si do paraqiten në tab.

Forma e kontributit të tyre është shprehur duke komentuar dispozitat të caktuara dhe njëkohësisht duke sugjeruar për plotësimin e tyre apo ndryshimin e tyre.

Qështje tjera

Procesi i konsultimit është zhvilluar në bashkëpunim me ekspert të fushës së menaxhimit të mbeturinave, sidomos në mbështetje nga GIZ dhe objektivat kryesore që synojnë të arrihen me politikë - eliminimi i Licencimit për menaxhimin e mbeturinave, që konsiderohet si lehtësim/reduktim i lejitimeve në fushën e mjedisit, dhe që do të kompensohet me Lejen mjedisore dhe Lejen mjedisore komunale.

Gjithashtu janë bërë edhe ca plotësime lidhur me eksportin dhe importin e mbeturinave, si dhe ndryshimi i përcaktimit të vetive të mbeturinave të rrezikshme, bazuar në ndryshimin e legjislacionit të BE-së (lidhur me Shtojcën tre të daraftligjit).

Si rezultat i procesit të vlerësimit dhe konsultimit të kryer janë:

- Eliminimi i procesit të licencimit është një qështje kryesore e synuar, si lehtësim për bizneset dhe publikut që merret me fushën e mbeturinave.
- Ligji për mbeturina dhe legjislacioni sekondar që del nga ky ligj, se duhet të harmonizohen dhe koordinohen me legjislacionin tjetër mjedisor (qasja e integruar) si dhe nderlidhja me zbatimin e Acquis-it të BE-së;
- Legjislacioni për mbeturina edhe më tej do të duhet të përafrohet me standardet e përgjithshme aktuale për hartimin e akteve ligjore (psh harmonizimi me dispozitatave ndëshkuese të Ligjit për kundërvajtje etj.);

Hapat e ardhshëm

Pas përfundimit të procesit të konsultimit dhe finalizimit të dokumentit palët do të informohen për miratimin nga Ministri i MMPHI dhe do të publikohet në web faqen e MMPHI dhe Gazetën Zyrtare të RKS.

Shtojca – tabela e detajuar me informatat për kontribuesit, arsyetimet për përgjigjet e pranuar dhe të refuzuara.

Emri i i organizatës /individit	Koment i i organizatës /individit	Përgjigja nga Ministria	Sqarim nga Ministria
--	--	--------------------------------	-----------------------------

			(veçanërisht arsyet për të mos pranuar komente të caktuara)
Ministria e Drejtësisë	<p>Projekt Ligjin Nr. ___Për Ndryshimin dhe Plotësimin E Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina, i pranuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infstrukturës në konsultime paraprake, përmban dispozita ndëshkimore dhe atë nga neni 42 paragrafi 1. (Kjo shumë e përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 29 të Ligjit Nr. 05/L-087 për kundërvajtje, mund të dyfishohet nëse vepra kundërvajtëse është kryer nën rrethanat e përcaktuara sipas nenit 29 të Ligjit, përkatësisht për kundërvajtjet nga fusha e: <i>mbrojtjes së shëndetit; mbrojtjes së mjedisit jetësor; mbrojtjes së konsumatorëve; mbrojtjes së konkurrencës në treg; të mirave kulturore; të ndërtimitarisë; të informimit publik; sigurisë dhe mbrojtjes në punë; të hyrave publike dhe doganës.</i>), dhe paragrafi 2., neni 44 paragrafi 2., neni 45 paragrafi 1. dhe nën paragrafët 1.1., 1.2., 1.3., 1.4. , 1.5., 1.6., dhe 1.7. Dispozitat e lartë përmendura të këtij projektligji janë në përputhje me nenin 29 të Ligjit Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje dhe po ashtu dispozitat e këtij projektligji të cilat përcaktojnë gjoha ndaj personit fizik, personit juridik dhe personit përgjegjës të personit juridik janë në harmoni me nenin 29 të Ligjit për kundërvajtje.</p>	E pranuar	
INDEP	<p>- Neni 2 i Projektligjit, formulimi i ri që zëvendëson nenet 1 dhe 2 të Ligjit aktual. Të plotësohet me shprehjen në bold si në vijim: “Ky ligj ka për qëllim përcaktimin e rregullave për menaxhimin e mbeturinave dhe masat për të mbrojtur mjedisin dhe shëndetin e njeriut duke promovuar riciklimin, duke parandaluar ose zvogëluar gjenerimin e mbeturinave, ndikimet e pafavorshme të gjenerimit dhe menaxhimit të mbeturinave dhe duke zvogëluar ndikimet e përgjithshme të përdorimit të burimeve dhe duke përmirësuar efikasitetin e përdorimit të tillë, të cilat janë thelbësore për kalimin në</p>	E pranuar	

	<p>një ekonomi qarkore dhe për garantimin e konkurrencës.”</p> <p>Riciklimi i mbeturinave është një ndër parakushtet për uljen e gjenerimit të mbeturinave dhe promovimin e një ekonomie qarkore. Duke përfshirë riciklimin si term në Ligjin aktual Kosova përqon mesazhin se me legjislacion synohet të promovohet riciklimi si praktikë për mbërritjen e qëndrueshmërisë.</p>		
	<p>- Neni 3 i Projektligjit që shton paragrafin 64 të nënparagrafit 1 të nenit 4 të Ligjit aktual. Skema e zgjeruar e përgjegjësisë së prodhuesit e vendosur në definim të sqarohet më tutje në projektligj me një nen të veçantë. Në formën aktuale, vetëm është vendosur një definim i pacaktuar qartë “një sërë masash” pa specifikuar se cilat masa. Ne konsiderojmë që ky grup masash janë jashtëzakonisht të rëndësishme për të aplikuar parimin “ndotësi paguan”. Ligji duhet të jetë specifik për të caktuar se për çfarë përgjegjësie financiare po flasim apo se cila do të jetë forma e mbajtjes së përgjegjësisë. A do t’i obligohet trajtimi i mbetjeve vet prodhuesit apo do të obligohet të paguaj një shumë financiare? Sa do të jetë kjo shumë për njësi? Përgjigjet për këto pyetje nuk mund të lihen për t’u me akte nënligjore por duhet të jenë subjekt i një diskutimi të gjerë shoqëror që arrihet vetëm duke u përcaktuar me Ligj.</p>	E refuzuar	<p>Neni 3 – është kaluar në nenin 4, të draftligjit</p> <p>Propozimi refuzohet për arsye se për qështjen e – Skema e zgjeruar e përgjegjësisë së prodhuesit do të rregullohet me një akt nënligjor siç është propozuar në nenin 11 të projektligjit.</p> <p>Sa i përket propozimet se duhet të jenë subjekt i diskutimit të gjërë shoqëror kjo nënkupton se edhe aktet nënligjore procesin e konsultimit e kanë të njejt sikurse edhe ligjet.</p>
	<p>- Neni 5 i Projektligjit që ndryshon Paragrafin 2 të nenit 8 të Ligjit bazik Ne propozojmë që dispozita të mbetet siç ka qenë në Ligjin aktual në fuqi. Planet për menaxhimin e mbeturinave nga zotëruesit e mbeturinave dhe nga personat e pajisur me leje të caktuar mjedisore duhet të jenë në harmoni me planet komunale për menaxhimin e mbeturinave përkatësisht planin kombëtar. Një zotërues i mbeturinave duhet të ketë parasysh patjetër planin komunal me rastin e hartimit të planit të menaxhimit të mbeturinave ashtu që të jetë në harmoni me objektivat e këtij plani.</p>	E refuzuar	<p>Neni 5 kalon në nenin 6 të këtij Projektligji.</p> <p>Planet e zoteruesve të mbeturinave janë autonom, janë plane të prodhuesit ose zoteruesit në një kompani që nuk do të thotë të janë të harmonizuar me planin Komunal për mbeturina ose me Strategjinë dhe planin për mbeturina.</p>

	<p>Kështu, edhe komunave ju imponohet pozitivisht një debat më i gjerë shoqëror me rastin e miratimit të këtyre planeve komunale por edhe operatorëve në anën tjetër u obligohet që të zbatojnë menaxhimin e mbeturinave duke u bazuar në projeksionet e planeve komunale përkatësisht planit kombëtar kur kemi të bëjmë me mbeturina të rrezikshme.</p>		
	<p>-Neni 6 i Projektligjit që fshin nenin 12 paragrafin 4 të ligjit bazik. INDEP propozon që paragrafi 4 i nenit 12 të Ligjit në fuqi të mos fshihet por të riformulohet si në vijim: “Planin e veprimit për menaxhimin e mbeturinave, operatorët e nxjerrin për periudhën një (1) vjeçare.” Projektligji aktual, siç e pamë nga komenti paraprak fillimisht ka hequr obligimin e operatorëve për të harmonizuar planet e tyre me planet komunale ndërsa në këtë dispozitë heqet fare periudha të cilën duhet ta përfshij plani. Pra, periudha tre (3) vjeçare është larguar pa dhënë ndonjë periudhë tjetër si opsion. Ne propozojmë që kjo periudhë të bëhet një (1) vjeçare. Kjo pasi, duke pasur një periudhë më të shkurtër të realizimit, planet do të jenë më lehtë të monitorueshme dhe do të mund të ndryshohen varësisht nga kërkesat e zhvillimit të zonave të caktuara, gjithnjë në përputhje me planet pesë (5) vjeçare komunale. Periudha e planeve njëvjeçare të operatorëve gjithashtu lejon që në raportet vjetore që dorëzohen në komunë apo ministri të raportohet për planin vjetor.</p>	<p>E pranuar pjesërisht</p>	<p>Neni 6 i Projektligjit kalon në nenin 7 të Projektligjit</p> <p>Paragrafi 4. i Nenit 12 të ligjit bazik propozohet të riformulohet.</p> <p>Propozimi për periudhe një vjeçare është shumë i shkurtër dhe propozohet të jetë 5 vjeçar në përputhje me afatin e Lejes Mjedisore përkatëse</p> <p>Pra, paragrafi 4 i nenit 12, të ligjit bazik nuk ndryshohet fare</p>
	<p>Neni 8 i Projektligjit që ndryshon nënparagrafin 1.5 të paragrafit 1 të nenit 15 të Ligjit aktual në fuqi. INDEP propozon që kjo dispozitë të mos ndryshohet fare. Projektligji me këtë dispozitë obligon komunat që të krijoj njësi të veçantë ose të ngarkoj zyrtarë me obligime dhe detyra për menaxhimin e mbeturinave. Kjo praktikë e legjislacionit që në njërin anë të krijoj obligime për komunat e në anën tjetër institucionet e nivelit qendror të mos lejojnë</p>	<p>E refuzuar</p>	<p>Neni 8 i Projektligjit kalon në nenin 9 të Projektligjit Dipozita e paraparë në projektligj është opsionale.</p> <p>1.5. Komuna është e obliguar që të krijoj njësinë ose të përcaktoj së paku një zyrtarë me detyra dhe përgjegjësi për menaxhimin e mbeturinave, në territorin e tyre;</p>

	<p>staf shtesë komunave për të mbuluar këto praktika janë të padrejta. Ndonëse ne jemi që Ligji të përcaktoj obligime për komunat, nuk jemi që komunave t'u obligohet njësi apo zyrtar të veçantë për këtë fushë pa pasur përkrahje shtesë nga niveli qëndror. Në rastin konkret, komunave u mbetet obligimi por duhet t'u lihet nën diskrecionin e tyre se si ta organizojnë punën brenda komunës në mënyrë që të realizohen objektivat e Ligjit.</p>		
	<p>-Neni 10 i Projektligjit që shton paragrafin 4 të nenit 17 të Ligjit aktual në fuqi. INDEP propozon që “Sistemi për Rimbursimin e Depozitës” të përcaktohet fillimisht në nenin 4 tek Përkufizimet dhe pastaj të rregullohet me një nen të veçantë. Në versionin aktual, ky Sistem nuk është definuar fare tek neni 4 dhe nuk është sqaruar më tutje. Sistemi për Rimbursimin e Depozitës në versionin aktual mbetet një koncept i pakuptimtë dhe i pasqaruar. Për më tepër mungon një nen i veçantë që do të sqaronte për çfarë sasie të depozitës bëhet fjalë dhe si funksionon rimbursimi.</p>	E pranuar	<p>Neni 10 kalon në nenin 11 . Është shtuar përkufizimi në nenin 4 të projektligjit nënparagafi 1.65.</p>
	<p>-Neni 12 i Projektligjit që ndryshon nenin 19 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit aktual në fuqi. Tek paragrafi 1 i nenit 12 të Projektligjit propozojmë të hiqet shprehja “të rrezikshme”. Tek paragrafi 2, ne propozojmë që gjithashtu të hiqet shprehja “të rrezikshme”. Gjithashtu, të plotësohet si në vijim: “Personi pajiset me leje për transportimin e mbeturinave, sipas dispozitave të ligjit, dhe detyrohet:” Në plotësim-ndryshimin e propozuar tani, norma i referohet vetëm mallërave të rrezikshme duke e ndryshuar kuptimin e deritanishëm të saj sipas ligjit në fuqi. Ne propozojmë që të mbetet në fuqi përfshirja edhe e mbeturinave të tjera përveç mbeturinave të rrezikshme. Kjo është në përputhje edhe me principin e 3-të vigjilencës dhe parandalimit sipas nenit 5 të Ligjit në fuqi. Paragrafi 2 ka nevojë të plotësohet edhe për të hequr kufizimin e mbeturinave të</p>	E pranuar pjesërisht	<p>Neni 12 kalon i projektligjit në nenin 13 të projektligjit. Konsiderohet se do të ishte e nevojshme leje vetem për mbeturinat e rrezikshme, dhe adresimi është bërë që leja të merret sipas procedurave që janë përcaktuar me Ligjin për transportimin e mallrave të rrezikshme. Fjala detyrohet është inkorporuar</p>

	<p>rrezikshme sipas komentit të mësipërm por edhe sepse gjuhësisht duhet të mbetet pjesa “dhe detyrohet” që të siguroj rrjedhë koherente me pjesën tjetër.</p>		
	<p>-Neni 21 i Projektligjit që riformulon paragrafin 3 të nenit 29 të Ligjit aktual në fuqi. Ne propozojmë të fshihet shprehja “dhe që mbetja nga ky proces mekanik nuk ka vlerë përdorimi”. Në versionin aktual të Projektligjit, mund të keqkuptohet që çdo mbeturinë që nuk ka vlerë përdorimi mund të digjet. Gjithashtu, definimi është i mjegullt pasi nuk dihet se si përcaktohet në të vërtetë nëse mbetja nuk ka vlerë përdorimi apo ka. Si e tillë, heqja e kësaj shprehje do të jepte më shumë qartësi dhe saktësi</p>	E pranuar pjesërisht	<p>Neni 21 i Projektligjit, kalon ne Nenin 22 te projektligjit.</p> <p>Është riformuluar 3. Djegia e mbeturinave komunale bëhet vetëm pas ndarjes së mbeturinave në lloje, përmes procesit mekanik, ose teknologjik, ose ndarjes manuale. Mbeturinat e veçuara që nuk kanë vlerë për përdorim ose riciklim, si të tilla mund të digjen për përfitim të energjisë ose të deponohen në deponi të mbeturinave komunale.</p>
	<p>-Neni 24 i Projektligjit që fshin paragrafin 5 të nenit 39 të Ligjit aktual në fuqi. Ne propozojmë që paragrafi 5 i nenit 39 të Ligjit aktual në fuqi të mos fshihet. Dispozita nga paragrafi 5 i nenit 39 të Ligjit në fuqi është shumë e rëndësishme për arritjen e objektivit për zhvillim të qëndrueshëm, mbrojtje të mjedisit dhe shëndetit të qytetarëve. Ministria duhet të angazhohet në fuqizimin e zbatimit të normës juridike nëse ajo nuk po gjenë zbatim ose ndërtim të mekanizmave për zbatimin e saj dhe jo të propozoj largimin e një standardi apo degradimin e kriterëve ligjore.</p>	E refuzuar	<p>Neni 24 i projektligjit kalon në nenin 25 të projektligjit</p>
	<p>-Neni 26 i Projektligjit që riformulon paragrafin 4 të nenit 42. Ne propozojmë që paragrafi 4 i nenit 42 të mos ndryshohet nga Ligji aktual. Përveç që në vend të shprehjes “i licencuar” mund të bëhet “i pajisur me leje mjedisore” pjesa tjetër është më e qartë dhe me gjuhë më të thjeshtë në Ligjin aktual sesa në Projektligj.</p>	Pjesërisht e pranuar	<p>Neni 26 projektligjit kalon ne nenin 28 te projekt ligjit</p> <p>Një sitem i kthimit të gomave aktualisht nuk ka një mundësi të tillë për të u kthyer gomat e përdorura të prodhuesi ose importuesi. Nëse do të krijohet ky sistem atëher gomat jashtë</p>

			<p>përdorimit do të kthehen. Megjithatë obligimi për dorëzimin e gomave jashtë përdorimit të personat e pajisur me leje përkatëse mjedisore duhet të mbetet</p> <p>Paragrafi 4 në projekt ligj riformulohetsi vijon:</p> <p>4. Zotëruesi i gomave jashtë përdorimit duhet ti dorëzojnë ato të operatorët që janë të pajisur me leje përkatëse mjedisore, ose të i kthejnë ato te prodhuesi, importuesi, nëse një sitem i kthimit është i rregulluar.</p>
	<p>-Neni 34 i Projektligjit që fshin në tërësi nenin 54 të Ligjit aktual në fuqi.</p> <p>Propozojmë që neni 34 të fshihet krejtësisht nga Projektligji dhe rryedhimisht neni 54 i Ligjit në fuqi të mbetet i pa cenuar.</p> <p>Neni 54 i Ligjit në fuqi rregullon një sektor shumë të rëndësishëm, mbeturinat e të cilit janë përgjegjëse për ndotjen e mjedisit, rrezikimit nga përmblytjet, rrezikimit të shëndetit publik etj.</p> <p>Në vitin 2017, INDEP ka analizuar bazën aktuale ligjore dhe ka propozuar një Ligj të veçantë për menaxhimin e mbeturinave industriale. Duke qenë se ai Ligj ende nuk është miratuar, dhe deri në miratimin e tij, dispozitat e nenit 54 të Ligjit aktual duhet të mbeten në fuqi. INDEP konsideron që duke respektuar parimin “ndotësi paguan”, trajtimi i mbetjeve nga industria të jetë përgjegjësi e vet operatorëve nën mbikëqyrjen e shtetit. Sidoqoftë, shfuqizimi i kësaj dispozite duhet të bëhet vetëm nëse miratohet një Ligj i veçantë për Trajtimin e Mbetjeve Industriale.</p>	E refuzuar	<p>Neni 34, Projektligjit, kalon në nenin 39 të Projektligjit.</p> <p>Projektligji për mbeturinat nga industria e nxjerrjes së mineraleve është në hartim e sipër .</p>
	<p>Neni 35 i Projektligjit që fshin paragrafit 3 të Nenit 55 të Ligjit aktual në fuqi.</p> <p>Propozojmë që paragrafi 3 i nenit 55 i Ligjit në fuqi të mbetet i pa cenuar.</p> <p>Specifikat kryesore të Licensës është e rëndësishme që të mbesin si kategori ligjore.</p>	E refuzuar	<p>Neni 35 i Projektligjit kalon në Nenin 40 të Projektligjit.</p> <p>Të gjitha specifikat që bartë licenca janë të specifikuar në dispozitat</p>

	<p>Kjo sepse, Ligji është dokument që obligon Ministrinë që çdo Leje të ketë së paku komponentët e përmendura nën këtë nen. Kjo siguron kualitetin e lejeve që lëshohen dhe siguron që ato lëshohen bazuar në një set bazik të kriterëve.</p>		<p>ligjore për lejet përkatëse mjedisore.</p>
	<p>Neni 36 i Projektligjit që fshin paragrafët 6, 7 dhe 8 të Nenit 55 të Ligjit aktual në fuqi. Propozojmë që paragrafët në fjalë të nenit 55 të mbeten si të tilla.</p> <p>Afati 60 ditor që i jepet Ministrisë për lëshimin e Licencës (që mund të rivedinohet si Lejes) është i rëndësishëm që të mbetet për të mbrojtur interesat e operatorëve dhe për të vënë një afat tavan për Ministrinë që të kryej punën e vet për lëshimin e lejes. Si e tillë duhet të mbetet. Gjithashtu paragrafët 7 dhe 8 është e rëndësishme të mbesin në fuqi për të përcaktuar obligimin për njoftim në rast të pamundësisë për kryerjen e menaxhimit si pasojë e forcës madhore si dhe obligimin që Ministria me akt nënligjor të specifikojë më tutje kushtet dhe specifikat e lejes.</p>	E refuzuar	<p>Neni 35 i Projektligjit kalon në Nenin 40, të Projektligjit</p> <p>Procedurat për lëshimin/nxjerrjen e Licences në Projektligj anulohen.</p> <p>Kushtet për rastet emergjente / apo të forcës madhore do të duhet të përcaktohen nga aktet e Ligj Nr. 04/-L-027 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.</p>
	<p>Neni 38 i Projektligjit që riformulon paragrafin 4 të nenit 58 të Ligjit në fuqi. Propozojmë që paragrafi në fjalë të riformulohet si në vijim: “Operatorët që merren me menaxhimin e mbeturinave paraqesin Raportin vjetor deri më 31 mars të vitit vijues. Raporti paraqitet në Komunë apo në Ministri.”</p> <p>Projektligji duhet t’i ofroj një lehtësi operatorëve që të mos kenë obligim që të dorëzojnë raportin edhe në Ministri edhe në Komunë. Kjo mund të aplikohet vetëm kur kemi të bëjmë me materiale të rrezikshme.</p>	E refuzuar	<p>Neni 38, i Projektligjit kalon në Nenin 43 i Projektligjit.</p> <p>Për shkak të mbledhjes së informatave dhe funksionalizimit të Sistemit Informativ sa me të kompletuar</p> <p>-Operatorët duhet që të raportojnë edhe në Komunen e tyre por edhe në Ministrinë përkatëse për mjedis- në Agjencionin për Mbrojtjen e Mjedisit.</p>
	<p>Neni 39 i Projektligjit që fshin paragrafin 5 të nenit 60 të Ligjit aktual në fuqi. Ne propozojmë që paragrafi në fjalë të mos fshihet por të riformulohet si në vijim: “Të hyrat nga mjetet financiare, sipas paragrafit 1. të këtij neni, do të trajtohen si të dedikuara për adresimin e çështjeve të ndotjes nga mbeturinat dhe shfrytëzimi i tyre do të</p>	E refuzuar	<p>Neni 39 i Projektligjit kalon në Nenin 44. të Projektligjit</p> <p>Me këtë ligj nuk do rregullohet asnjë metodologji për shfrytëzimin e mjeteve</p>

	<p>përcaktohet përmes akteve nënligjore të cilat do të nxjerrin Ministria dhe Komunat në kuadër të kompetencave menaxhuese që kanë sipas këtij</p> <p>Duke trajtuar këto të hyra si të dedikuara dhe për t'u shfrytëzuar për qëllimin për të cilin mbledhen, respektohet parimi “ndotësi paguan” dhe rritet alokimi i mjeteve për të punuar në reduktimin e ndotjes dhe rritjen e vetëdijësimit të qytetarëve. Gjithashtu, duke dedikuar këto të hyra, rritet kapaciteti i komunave dhe institucioneve qëndrore për të adresuar çështjet e ndotjes nga mbeturinat përfshirë informimin ligji.” dhe vetëdijësimin e qytetarëve, masat mitiguese për ndotjen apo investimet në drejtim të riciklimit apo uljes së gjenerimit të mbeturinave.</p>		<p>financiare si për Ministrinë ashtu edhe për Komunat.</p> <p>Rregullat e shfrytëzimit të të hyrave financiare janë rregulluar me Ligjin për Financa – që planifikohen sipas buxhetit të Republikës së Kosovës.</p>
	<p>Neni 42 i Projektligjit, që riformulon paragrafin 1 të nenit 71 të Ligjit aktual në fuqi.</p> <p>Të bëhet kategorizimi i shkeljeve dhe përcaktimi i nivelit të gjobës për secilën shkelje.</p> <p>Aktualisht, gama e gjobave nga 5 mijë në 40 mijë e përcaktuar në Projektligj është shumë e gjerë dhe lë mundësi të interpretimit subjektiv. Ne propozojmë që të kategorizohen dhe specifikohen shkeljet ngjashëm si me rastin e nenit 45 të Projektligjit ku janë specifikuar shkeljet dhe gjobat nga paragrafi 1 i nenit 74 të Ligjit bazik.</p>	E refuzuar	<p>Neni 42, i Projektligjit kalon në nenin 47, i Projektligjit.</p> <p>Është e pamundur që vlera e shkeljes / dëmit të përcaktohet për secilën shkelje pa një proces vlerësimi, i cili do të bëhet përmes ekspertizës. Mund të ndodhë që një shkelje në një rast të vlerësohet psh. me 5.000 euro, dhe në një rast tjetër mund të vlerësohet psh. me 12.000 euro.</p>
	<p>Neni 42 i Projektligjit që fshin nënparagrafin 1.43 të paragrafit 1 të nenit 71 të Ligjit bazik. Ne propozojmë që kjo dispozitë të mos hiqet. Ne kemi propozuar që të mbetet në fuqi paragrafi 7 i nenit 55 të Ligjit aktual në atë mënyrë që të mbetet obligimi për njoftim në rast të pamundësisë për të bërë menaxhimin e mbeturinave si pasojë e forcës madhore. Ky detyrim ne kemi argumentuar më sipër që duhet të mbetet e po ashtu edhe që për këtë shkelje të mbetet në fuqi gjoba a paraparë në nënparagrafit 43 të paragrafit 1 të Ligjit.</p>	E refuzuar	<p>Neni 42 i Projektligjit kalon në Nenin 47, i Projektligjit</p> <p>Paragrafi 7 i Nenit 55 i ligjit bazik është i fshirë, dhe i cili edhe ashtu nuk kishte të përcaktuara/rregulluara që do të definonte kushtet e forcës madhore që do të pamundësonte menaxhimin e mbeturinave.</p>

			Kushtet e tilla nuk janë përcaktuar në ndonjë dispozite të Ligjit bazik , por edhe me legjislacion sekondare
	<p>Neni 43 i Projektligjit që riformulon nënparagrafin 1.1 të paragrafit 1 të nenit 72 Ne propozojmë që riformulimi i Projektligjit të ndryshohet dhe në vend të shprehjes “personit juridik” të bëhet “person fizik”. Konsiderojmë që dispozita në fjalë e nenit 72 ka për qëllim personin fizik përgjegjës për personin juridik dhe jo personin juridik siç është formuluar në këtë Projektligj. Për këtë propozojmë formulimin sipas propozimit tonë.</p>	E refuzuar	<p>Neni 43 i Projektligjit, kalon në nenin 48 të Projektligjit</p> <p>Në këtë nen kemi të bëjmë për personat juridik gjithashtu, por duke përdorur edhe forma të tjera për ndëshkim ndaj përsoneve, që nuk respektojnë dispozitën ligjore</p>
(GIZ) GmbH	<p>Direktiva Kornizë e Mbeturinave 2008/98 / EC është transpozuar në Ligjin për Mbeturinat dhe niveli i pajtueshmërisë është mjaft i lartë. Direktiva Kornizë e Mbeturinave u ndryshua disa herë dhe këto ndryshime nuk janë adresuar plotësisht me Projektligjin e propozuar. Disa çështje që ende nuk janë adresuar në plotni për të siguruar përputhshmërinë me Acquis të BE-së dhe zbatimin e ligjit, përfshijnë: parandalimin e mbeturinave; skemat dhe pajisjet e mbledhjes së ndarjeve; rikuperimi i mbeturinave; rregullat për llogaritjen e arritjes së synimeve; kërkesat minimale të përgjithshme për skemën e zgjeruar të përgjegjësisë së prodhuesit.</p>	E pranuar	Vlerësimi është real
	<p>Në nenin 3 të Projektligjit i cili ndryshon nenin 4 të ligjit bazë, MMPHI duhet të sigurojë që të gjitha përkufizimet përkatëse janë të transpozuar siç duhet me ato të përcaktuara në Direktivën Kornizë të Mbeturinave, dhe përkufizimet që mungojnë (p.sh. rikuperimi) të eanë përfshirë në Projektligj.</p>	E pranuar	<p>Porosia është vlerësuar e realizuar</p> <p>Definicioni i rekuperimit në ligjin bazik është definuar me fjalën përpunim (Rikuperim ose recovery,)</p>
	<p>Neni 10 i Projektligjit paraqet bazën ligjore për kërkesat dhe proceset në lidhje me Skemën e Zgjerua të Përgjegjësisë së Prodhuesit që të rregullohen përmes legjislacionit sekondar në përputhje me</p>	E pranuar	Neni 10 Projektligjit kalon ne Nenin 11 të Projektligjit,

	<p>parimin ndotësi paguan. Ky nen gjithashtu lejon që kriteret, përgjegjësitë dhe procedurat për krijimin e Sistemit të Rimbursimit të Depozitave të përcaktohen më tej me legjislacionin sekondar. Gjatë procesit të hartimit të akteve nënligjore, MMPHI duhet të sigurojë pajtueshmërinë me kërkesat e paraqitura në Direktivën Kornizë të Mbeturinave.</p>		<p>Porosia është vlerësuar e realizuar</p>
	<p>-Gjatë procesit të thjeshtimit të kërkesave për licenca dhe leje, MMPHI duhet të siguroj që thjeshtimi nuk paraqet pengesa në përmbushjen e kërkesave të cilat janë të përcaktuara në Direktivën Kornizë të Mbeturinave. Neni 35 i Projektligjit i ka fshirë paragrafët 2 dhe 3 të nenit 55 të Ligjit bazik i cili specifikon elementet që duhet të përmbajë një leje. Këto elemente janë specifikuar gjithashtu në nenin 23 të Direktivës Kornizë të Mbetjeve.</p> <p>Sidoqoftë, neni 23 paragrafi 5 i Direktivës u lejon shteteve anëtare mundësinë për të formuar një leje të vetme, me kusht që kërkesat e parashikuara në nenin 23 janë të përcaktuara dhe arrihen në mënyrë që të shmangët duplikimi i panevojshëm i informacionit dhe përsëritja e punës së njëjtë nga operatori (biznesi) ose administrata. Në këtë drejtim, Projektligji ka bërë një referencë të re në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit. Kjo e fundit nuk ka një referencë të qartë për elementet që duhet të përmbajë një leje siç parashihet në nenin 23 të Direktivës. Prandaj, duhet të sigurohet që procesi i thjeshtimit të licencave dhe lejeve nuk e pengon pajtueshmërinë me Direktivën Kornizë të Mbeturinave në rastet kur bënë thjestimin e licencave apo lejeve.</p>	<p>E refuzuar</p>	<p>Të gjitha specifikat që bartë licenca janë të specifikuara në dispoziat ligjore për lejet përkatëse mjedisore.</p>
	<p>-Gjobat dhe sanksionet e përcaktuara në Projektligj duhet të diskutohen dhe shqyrtohen nga Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës për të siguruar që ato të jenë proporcionale dhe në përputhje me Kodin Penal dhe Ligjin për Kundërvajtjet.</p>	<p>E pranuar</p>	<p>Është marr vlerësimi nga Ministria e Drejtësisë</p>

	-Për të qenë në përputhje me kërkesat, objektivat dhe synimet e përcaktuara në direktivat e BE-së, MMPHI, përveç përafrimit të mëtejshëm të kornizës së saj ligjore, duhet të investojë në burime që sigurojnë zbatimin e kornizës ligjore. Këto çështje janë të lidhura ngushtë me draftin aktual të Strategjisë për Menaxhimin e Integruar të Mbeturisë, miratimi i së cilës duhet të jetë prioritet nga Qeveria.	E refuzuar	Qështje që ligji orjenton me detyrim për planifikim përmes dokumenteve planifikuese.
Zyra Ligjore e Kryeministrit/ZKM	- Qëllimi i këtij ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 04/L-060 për mbeturina, Gazeta Zyrtare Nr. 17/29 Qershor. 2012 (Në tekstin në vijim: ligji bazik). Të specifikohet, meqenëse në këtë mënyrë në tekstin në vijim nuk do të shkaktojë konfuzion.	E pranuar,	Është marruar parasyshë dhe si i tillë është shënuar në çdo situatë referuese si: „ Ligji bazik”
	- Neni 1 dhe 2 , i ligjit bazik, fshihen dhe perseri riformulohet, si në vijim: Në rastet kur kemi të bëjmë me riformulim, është mirë që të mos përdoret edhe termi ‘fshihen’, pasi që është e kuptueshme nëse përcaktohet se riformulohet. Ju lutem që ta kenë parasysh nenin 10, paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative, i cili përcakton: ‘2. Ndryshimi, plotësimi ose shfuqizimi i një neni ose nënndarjeve të tij duhet të bëhet përmes një paragrafi të veçantë për çdo nen.’ Andaj në bazë të kësaj dispozite të ndahen në paragrafë të veçantë, si dhe paragrafi të merr një numër rendor. Ky koment vlen për të gjithë tekstin e Projektligjit.	E pranuar	Nga neni 2 i Projektligjit ndahen nene të rinjë- neni 2 dhe neni 3 të Projektligjit
	Në nenin 12 , paragrafi 4, i ligjit bazik, fshihet. Propozojmë që të përdoret një formë unike në tërë tekstin, p.sh.: Në nenin 12, të ligjit bazik, paragrafi 4 fshihet. Të përdoret në këtë formë edhe te neni 4 dhe 5 i këtij Projektligji.	E pranuar	
	Neni 10 në nenin 17, të ligjit bazik, paragrafi 3 fshihet dhe riformulohet si në vijim:	E pranuar pjesërisht	Është e rregulluar si përgjegjësi e prodhuesit importuesit të mallrave, do

	<p>Ministria me akt nënligjorë përcakton përgjegjësinë e zgjëruar të prodhuesit dhe importuesit sipas parimit ndotësi pagan.</p> <p>A është e nevojshme që të përdoret ky term ‘përgjegjësi e zgjëruar’? Besoj se është e mjaftueshme që të thuhet se përcaktohet përgjegjësia e përdoruesve</p>		<p>të duhet që paragrafit 3 të draftligjit formulohet:</p> <p>3. Ministria me akt nënligjorë përcakton përgjegjësinë e zgjëruar të prodhuesit dhe importuesit të produkteve /mallit sipas parimit ndotësi pagan.</p> <p>Referohemi Legjislacionit të BE – së për mbeturina që ka përcaktuar parimin e përgjegjësisë së zgjëruar të prodhuesit të produktit dhe mbeturinës.</p> <p>Ndër këtë përgjegjësi nuk përjashtohet edhe importuesi i mbeturinave, që në një fjalë mund të gjitha këto terme zëvendësohen me zotëruesin e mbeturinave.</p>
	<p>-Neni 12 paragrafi 2.1. të bëjë transportimin e mbeturinave, në bazë të kushteve të përcaktuara me leje për transportimin e mbeturinave të rrezikshme;</p> <p>Nëse është ndryshuar paragrafi 2 i nenit 19, të rishikohet se a ka kuptim ky formulim. Është e nevojshme që të bëhet lidhja me paragrafin 2 të ndryshuar, andaj mund që të shtohet fjala ‘detyrohet’ të paragrafi i mësipërm ku bëhet riformulimi i paragrafit 2.</p>	<p>E pranuar</p>	<p>Neni 12 i Projektligjit kalon në nenin 13 të Projektligjit.</p> <p>Është rregulluar sipas udhëzimit nga ZKM, si vijon:</p> <p>2. Personi pajiset me leje për transportimin e mbeturinave të rrezikshme, sipas dispozitave të ligjit përkatës për transportin e mallrave të rrezikshme dhe detyrohet:</p> <p>2. Në nenin 19, të ligjit bazik, paragrafi 2, nenparagrafi 2.1 riformulohet, si në vijim:</p> <p>2.1. të bëjë transportimin e mbeturinave, në bazë të kushteve të përcaktuara me leje për transportimin e mbeturinave;</p>

	Neni 14 paragrafi 1.3. të deponoj mbeturinat, në bazë të kushteve të përcaktuara me ligj; Të përcaktohet me cilin ligj.	E pranuar	Neni 13 i Projektligjit kalon ne nenin 14 te Projektligjit. Me legjislacionin mjedisore,
	Neni 24 pragrafi 1. Personat që menaxhojnë vajrat mbeturinë dhe mbeturinat me vajra duhet të pajisen me leje. Propozojmë që të specifikohet se për cilën leje bëhet fjalë.	Pranohet	Neni 24 i projektligjit kalon ne nenin 25 te projektligjit Leje mjedisore përkatëse. Vërejtje në këtë nen është sygjerruar edhe nga INDEP
	Neni 25 Paragrafi 1, i nenit 40 dhe 41, të ligjit bazik, fshihet. Të ndahet në paragrafë të veçantë.	Pranohet	
	Paragrafi 2 dhe 3, i neni 55, i ligjit bazik, fshihet. Në paragrafin 3 të nenit 55 të ligjit bazik përcaktohen disa shënime të cilat janë specifikuar në licencë. A do të paraqiten këto shënime në lejen përkatëse mjedisore?	E refuzuar	Të gjitha specifikat që bartë licenca janë të specifikuara në dispozitat ligjore për lejet përkatëse mjedisore.
	Neni 41 Nën paragrafi 1.7. i paragrafit 1, i nenit 65, i ligjit bazik, fshihet dhe riformulohet si në vijim:1.7. të mbikëqyr kushtet e përcaktuara me leje përkatëse dhe në rast të mosrespektimin e këtyre kushteve, bënë propozimin për tërheqjen e lejes përkatëse mjedisore, nëse në afatin e caktuar nuk zbatohen masat e urdhëruara. A është fjala për lejen përkatëse mjedisore? Nëse parashihet se do të përcaktohen kushtet në lejen përkatëse mjedisore, atëhere edhe te neni 62, paragrafi 6.3 nuk ka nevojë të fshihet por vetëm të riformulohet dhe licenca për menaxhimin e mbeturinave të zëvendësohet me lejen përkatëse mjedisore.	E pranuar	Neni 41 kalon ne nenin 46 Nenparagrafet 6.3 dhe 6.4 të nenit 62 të ligjit bazik riformulohen
EU	Përputhshmëria e Ligjit për Mbeturina dhe ndryshimet e propozuara nga MMPHI me Acquis të BE-së, i gjeni të bashkangjitur që janë pergaditur nga ekspertët ligjorë të ekipit të projektit.	E pranuar	